



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/19) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit të paraqitur nga parashtrues i panjohur, në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 11.12.2020, morri vendimin vijues

VENDIM

NDËRPRITET procedura e udhëhequr nga lënda e formuar pas denoncimit të paraqitur nga parashtrues i panjohur deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të së cilit është formuar lëndë me numër 12-5517/1 nga viti 04.12.2019, tek i cili theksohet për dyshime për punë të paligjshme tëSHAnë likuidim, përkatësisht zvarritje të qëllimshme të procedurës nga ana e likuidatorëve drejtues dhe shoqërimin e tyre me avokatë, ekzekutues, likuidatorëve gjyqtarë etj.me qëllim të realizimit të përfitimit dhe shpëlarjes së parave nga pagesa e kamatës së vonuar nga, ashtu siç është e paraqitur në denoncim, nga borxhet e vjetruara nga shumë të ashtuquajtur debitorë.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit pas kontrollit të përmbajtjes së denoncimit dhe dokumentacionit shtesë të marrë dhe informata të vërtetuara që nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën nga shkakut se akuzat e denoncimit nuk janë vërtetuar dhe kanë vepruar organe të tjera kompetente.

Lënda me numër 12-5517/1 nga viti 04.12.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb-faqen e KSHPK në afat prej 5(pesë) ditësh nga dita e vendimmarrjes.

Sqarim

Lënda me numër 12-5517/1 nga viti 04.12.2019 është formuar në bazë të denoncimit të arritur nga parashtrues i panjohur.

Në denoncim theksohet për dyshime për punë të paligjshme SHA në likuidim, përkatësisht zvarritje të qëllimshme të procedurës nga ana e likuidatorëve drejtues dhe shoqërimin e tyre me avokatë, ekzekutues, likuidatorëve gjyqtarë etj.me qëllim të realizimit të përfitimit dhe shpëlarjes së parave nga pagesa e kamatës së vonuar nga, ashtu siç është e paraqitur në denoncim, nga borxhet e vjetruara nga shumë të ashtuquajtur debitorë.

Në denoncim gjithashtu theksohet për blerje të paligjshme të tokës ndërtimore në vendin me vlerë të madhe nga ana e personit zyrtar të mëparshëm në pronë të SHA -, ku i kanë ndihmuar këshilltarët e tij, drejtor i mëparshëm i Regjistrisëdhe, drejtor i mëparshëm i Gjithashtu, në denoncim theksohet kërkesë për inicim të procedurës kundër personave zyrtar të mëparshëm dhe drejtues të tjerë të falimentuar në lidhje me veprat e tyre akuzuese, si dhe të ndalohen urdhër pagesat për ekzekutim tek ekzekutuesitë cilat paguhen nga pensionistët.

Në lidhje me akuzat për zvarritje të procedurës për likuidim KSHPK u drejtua deri tek Gjykata themelore Shkup 2 të dorëzon informatë të plotë për procedurën e likuidimit dhe për rezultatin e të njëjtës. Nga lajmërimi i dorëzuar nga gjykata është konstatuar si në vijim:

Para Gjykatës Themelore qytetare Shkup në proces është procedura likuiduese mbi debitorin e likuidimitSHA- në likuidim. Përgjatë procedurës janë ndërruar më shumë likuidatorë drejtues dhe lajmëron se cili është likuidatori drejtues për momentin. Gjykata, gjithashtu, lajmëron se likuiduesi drejtues në bazë të fuqive të cilat i kanë në përputhje me dispozitat e Ligjit për falimentim i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për realizim të qëllimit të procedurës së likuiduar, ndërsa ajo është shlyerja e kreditorëve. Në shkresë theksohet se për çdonjërin veprim të ndërmarrë përgjigjet çdonjëri veçmas në përputhje me fushëveprimin e fuqive të tyre, dhe nga këtu del që gjyqi nuk mund të shoqërohet me asnjë nga personat e përmendur për të paguar borxhet e vjetruara nga të ashtuquajturit debitorë.

Gjithashtu, likuidatori gjykatës nuk ka inspektim në lëndët të cilat i udhëheq likuidatori drejtues, për të cilën udhëheqësi jep përgjegjësi në përputhje me dispozitat e Ligjit për falimentim dhe është i detyruar të vepron me ndërgjegje dhe profesionalizëm. Pagesa e kërkesave është në bazë të akteve ligjore të lejuara të cilat janë të bazuara me vendim të gjyqit e cila më tutje në procedurën finale paguhet nga ana e debitorëve. Debitorët mund t'i shfrytëzojnë ilaç juridik dhe të paraqet kundërshtim për ekzekutim i cili kundërshtim gjithashtu vendoset në gjykata, ndërsa pas ankesës vendoset në Gjykatën e Apelit në zonën e RMV.

Në lidhje me akuzat për përvetësim të paligjshëm të pronës nga ana e personit zyrtar, KSHPK veç më ka vendosur për lëndë të tillë me nr.12-1542/1 nga 04.12.2007 për çka në 2011 ka dorëzuar vendim që nuk janë të vërtetuara akuzat dhe lënda është mbyllur. Ndër të tjera, gjatë punës së kësaj lënde janë realizuar dhe takime me personat e tjerë të përmendur në denoncim edhe janë kërkuar dhe mbledhur të dhëna dhe informata nga institucione kompetente.

Në lidhje me kërkesën për ndalim të urdhër pagesave për ekzekutim tek ekzekutuesi i përcaktuar KSHPK nuk ka kompetencë për veprim.

Në bazë të gjendjes së tillë faktike të vërtetuar, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vlerësoi që nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm pas lëndës në përputhje me nenin 17 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, nga shkaku se akuzat në denoncim nuk janë të vërtetuara dhe kanë vepruar organe të tjera kompetente.

Duke e pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/19), vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Pas mbarimit të seancës së KSHPK:

Punoi: m-r B.K.SH., këshilltarë

Miratoi: m-r V.G., anëtar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËROР ПËR
PARANDALIM TË KORRUPSIONIT
Kryetar: Biljana Ivanovska